



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 611 /2024
Datë: 18 qershor 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 110 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 18 qershor 2024, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Detyrohen Autoritetet Kompetente (Kryeprokurorët e prokurorive përkatëse) që vendimet për hedhje dhe refuzim të ankesave t' i publikojnë në faqet zyrtare të prokurorive të cilat i menaxhojnë, në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Përrjashtohen nga publikimi në faqet zyrtare të prokurorive të Republikës së Kosovës kërkesat e Autoriteteve Kompetente me të cilat fillohet procedura e hetimit disiplinor për subjektet hetimore.
3. Obligohet Sekretariati që këtë vendim ta publikoj në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

A r s y e t i m

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në takimin e mbajtur më 18 qershor 2024, ka shqyrtuar çështjen e publikimit të vendimeve sipas Ligjit Nr. 06/L – 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe vendimeve të Autoriteteve Kompetente në funksion të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies.

Në këtë drejtim, KPK me qëllim që të respektohet parimi i transparencës dhe të mbahet i informuar publiku në lidhje me rrjedhën e ankesës, si dhe me procedurën e disiplinimit të prokurorëve deri në përfundim të kësaj procedure, me unanimitet vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ardian Hajdaraj



Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- *Autoriteteve Kompetente;*
- *Sekretariatit të KPK-së;*
- *Arkivit të KPK-së.*